

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE**

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT  
TË  
KËSHILLIT TË ETIKËS  
E  
UNIVERSITETIT TË ARTEVE**



Miratuar me Vendim Nr. 23, datë 06 / 03 /2020  
të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve



**Neni 1**  
**Baza ligjore**

Kjo Rregullore është hartuar në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Ligjit nr. 9131 datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", të Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Arteve (UART), si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me fushën e veprimit të këtij kodi.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat e veprimtarisë dhe funksionimit të Këshillit të Etikës të Universitetit të Arteve, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të tij, si dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

**Neni 3**

**Fusha e veprimit**

Kjo Rregullore i shtrin efektet e saj në të gjithë veprimtarinë dhe funksionimin e Këshillit të Etikës.


**Neni 4**  
**Këshilli i Etikës**

Këshilli i Etikës është organ kolegjial i Universitetit të Arteve. Këshilli i Etikës promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij artistik-kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale. Rregullat e organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Etikës janë të përcaktuara në Statutin e UART si dhe në Rregulloret e brendshme të Universitetit.

Këshilli i Etikës ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë me nismën e tij informacione nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe nga njësitë përbërëse të Universitetit të Arteve, lidhur me respektimin e kërkesave të moralit dhe të etikës në realizimin e funksioneve e detyrave të gjithsecilit. Këshilli i Etikës funksionon sipas parashikimeve të Kodit të Etikës dhe legjislacionit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 5**  
**Përbërja dhe Funksionet**

Këshilli i Etikës përbëhet sipas përcaktimeve të Statutit të Universitetit të Arteve. Këshilli i Etikës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Secili Fakultet i UART gëzon të drejtën e përfaqësimit me një anëtar nga stafi akademik i kategorisë "Profesor". Anëtari duhet të ketë një





eksperiencë pune mbi 10 (dhjetë) vjeçare në UART.

Njëri nga anëtarët e Këshillit të Etikës është anëtar i Senatit Akademik të UART. Anëtar i përfaqësues i Senatit akademik duhet të ketë një eksperiencë pune mbi 10 (dhjetë) vite në UART dhe të jetë i kategorisë “Profesor”

Njëri nga anëtarët e Këshillit të Etikës është i kategorisë “Student” në UART.

Mandati i anëtarëve të Këshillit të Etikës është 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Këshilli i Etikës merr vendime me shumicë votash dhe i paraqet rekomandimet e tij Senatit Akademik

Këshilli i Etikës është përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje, Kodit të Etikës, akteve të tjera të funksionimit të UART-së si dhe legjislacionit në fuqi.

Këshilli i Etikës është përgjegjës për zhvillimin e procedurave disiplinore që janë të parashikuara në Kodin e Etikës, duke përfshirë edhe të drejtën për të organizuar seancë dëgjimore për secilin person ndaj të cilit është paraqitur një ankesë për shkelje të Kodit të Etikës. Këshilli i Etikës propozon sanksione në rast të shkeljeve të Kodit të etikës.

Këshilli i Etikës ka të drejtë të bëjë rekomandime, mendime dhe përmirësime të Kodit të Etikës në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe më pas ti miratojë ato nga organi kompetent sipas përcaktimeve të Statutit të UART.

Këshilli i Etikës i paraqet Rektorit konstatimet e tij bashkë me rekomandimet përkatëse në përputhje me Kodin e Etikës, Statutin dhe Rregulloren e UART-së, sipas rastit.

Këshilli i Etikës shqyrton të gjitha ankesat që paraqiten pranë Zyrës së protokollit të Rektoratit të UART-së, në zbatim të këtij Kodi, brenda 10 ditëve pune nga paraqitja e ankesës/kërkesës.

Pjesë përbërëse e Këshillit të Etikës është edhe Sekretari/e i cili zgjidhet nga Rektori. Sekretar/e i/e Këshillit të Etikës është pjesë e stafit administrativ të UART, angazhimi i tij/saj është detyrë suplementare mbi atë për të cilën është i/e punësuar.

#### **Neni 6**

#### **Kryetari i Këshillit të Etikës**

Kryetari i Këshillit të Etikës zgjidhet me konsensus dhe me shumicë vote.

Kryetari i Këshillit të Etikës drejton mbledhjen, diskuton dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta dhe të arsyetuara.

Kryetari i Këshillit të Etikës mund të thërrasë mbledhjen përpara afatit të paracaktuar, në rast se situata dhe çështjet që do të diskutohen e përlligjin këtë veprim.

Në rast të mungesës së Kryetarit të Këshillit të Etikës për arsye shëndetësore ose arsye të tjera të justifikuara, mbledhja drejtohet nga anëtar i më i vjetër në moshë i Këshillit të Etikës me të drejtë vote.

#### **Neni 7**

#### **Thirrja dhe zhvillimi i mbledhjeve**

Këshilli i Etikës zhvillon mbledhje periodike minimalisht një në tre muaj. Mbledhjet mund të realizohen dhe në varësi të ankesave që paraqiten dhe që kërkojnë shqyrtim. Mbledhjet janë të vlefshme kur arrihet pjesëmarrja e më shumë se tre anëtarëve të Këshillit të Etikës. Agjenda e mbledhjes dakordësohet midis anëtarëve të Këshillit të Etikës, 1 (një) javë përpara zhvillimit të



saj. Agjenda tregon në mënyrë të detajuar dhe të qartë çështjet të cilat do të diskutohen. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhje jashtë parashikimit kur është paraqitur ankesë pranë Rektoratit, ankesë e cila kërkon vendimmartje. Çdo ndryshim në datën dhe në kohën e vendosur për mbledhjen e rradhës, i njoftohet çdo anëtar të Këshillit të Etikës, në mënyrë që të njihen me këto ndryshime. Për çdo mbledhje të Këshillit të Etikës mbahet procesverbal, i cili ruhet në dosjen përkatëse të mbledhjes së këtij Këshilli. Procesverbali mbahet nga Sekretari/e dhe duhet tu paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje, në fund të saj ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pasi miratohet, procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe nga Sekretari/e. Anëtarët e Këshillit të Etikës si dhe Sekretari/ia shpërblehen financiarisht. Shpërblimi miratohet nga Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve dhe kuadrit ligjor në fuqi.

### **Neni 8**

#### **Forma e votimit**

Vendimet përgjithësisht merren me votim të hapur, me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtë vote. Vendimet që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi merren me votim të fshehtë. Kur kërkohet një shumicë e cilësuar dhe kjo nuk arrihet, kryhet një votim i dytë. Në qoftë se edhe në votimin e dytë përsëritet e njëjta situatë, vendimi shtyhet për t'u marrë në mbledhjen e rradhës, në të cilën një shumicë e thjeshtë do të ishte e mjaftueshme. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, vota e Kryetarit është vendimtare.

### **Neni 9**

#### **Vendimet dhe Rekomandimet**

Vendimet dhe Rekomandimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje. Vendimet dhe Rekomandimet janë të vlefshme kur janë të nënshkruara nga Kryetari i Këshillit të Etikës. Çdo masë disiplinore hartohet në tre kopje, njëra prej të cilave arkivohet dhe tjetra i dërgohet strukturës/njesisë përkatëse për zbatim. Në Vendim dhe në Rekomandim duhet të përcaktohet qartë dhe saktë gjeneralitetet e personit, lloji i masës së propozuar, kohëzgjatja e masës (afatet e shuarjes sipas Rregullores së përgjithshme të UART) si dhe arsyetimi përkatës.

### **Neni 10**

#### **Dispozita përfundimtare**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik të Universitetit të Arteve.

Miratuar me Vendim Nr. 23, datë 06.03 2020  
të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve

